



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr. 366/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Rafet Haxhaj dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të Lartë Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkritazi me ankesën e Mentor Berisha kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Obiliq, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Obiliq, paraqitur për shkak të parregullsive në vendvotimin 1505e/01R,02D, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017 në seancën e panelit të mbajtur me 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa ZL A.nr 366/2017 e datës 23.10.2017, e parashtruar nga Mentor Berisha kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Obiliq nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Obiliq, paraqitur për shkak të parregullsive në vendvotimin 1505e/01R,02D, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 23.10.2014, nga Mentor Berisha nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Obiliq në të cilën pretendon se i janë vjedhur votat e tij në vendvotimet 1505e/01R,02D dhe kërkon nga PZAP-i që të behet rinumërimi i votave

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë përkritazi me manipulimin e votave në vendvotimin 1505e/01R,02D për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatit të votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit.

Hudhja e ankesës së ankuesit Mentor Berisha, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL Anr. 366/2017 më datën 24.10.2017



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.